



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E TIRANËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

**Sezoni 2020-2021**

**Kriteret dhe dokumentacioni i duhur, për aplikuesit që vijnë nga shtresat social-ekonomike në nevojë, të cilat i janë referuar kategorive vulnerabël sipas VKB-së Nr.158, datë 26.12.2019 “Për miratimin sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”**

➤ Dokumentacioni i duhur për secilën nga kategoritë:

**1. Fëmijë me statusin e jetimit**

- Libreza e statusit të jetimit të fëmijës
- Certifikata personale e fëmijës dhe familjare

**2. Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit**

- Libreza e statusit të kujdestarit ligjor të fëmijës
- Certifikata personale e fëmijës dhe familjare

**3. Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor**

- Raporti mjeko-ligjor i fëmijës
- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës

**4. Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor**

- Raporti mjeko-ligjor i kujdestarit ligjor të fëmijës
- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës

**5. Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike**

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim nga Njësia Administrative për trajtimin me ndihmë ekonomike të kujdestarit ligjor

**6. Fëmijët e familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës**

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim page i kujdestarit ligjor i cili duhet të jetë në/nën minimale të pagës në Republikën e Shqipërisë (26 000 lek)
- Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësorë për Individin nga portali zyrtar e-albania

**7. Fëmijët e familjeve, ku kujdestari ligjor i fëmijës, është i divorcuar ose i ve, (sipas certifikatës së gjendjes familjare), por që është në/nën pagën minimale në shkallë, vërtetuar me dokumentacionin përkatës**

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim page i kujdestarit ligjor i cili duhet të jetë në/nën minimale të pagës në Republikën e Shqipërisë (26 000 lek)
- Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësorë për Individin nga portali zyrtar e-albania

**8. Fëmijë të familjeve të pakicës rome dhe egjiptiane, sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre ose vetdeklarimi ku përcaktohet se familja është pjesë e këtyre pakicave**

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim të lëshuar nga organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre ose vetdeklarimi

**9. Fëmijët e vendosur në kujdestari nga familjet kujdestare, sipas legjislacionit në fuqi, vërtetuar me dokumentacionin përkatës**

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vendimi i gjykatës për dhënien e kujdestarisë

## **KRITERET DHE DOKUMENTACIONI I DUHUR PËR KATEGORITË E TJERA:**

- Certifikatë personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim pune me pagë mujore të pasqyruar, të kujdestarit ligjor (të prindërve)
- Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Individin nga portali zyrtar e-albania

### **Shënim:**

*Të nderuar prindër dhe të afërm të fëmijëve!*

Dokumentacionin e kërkuar si më sipër, mund ta shkarkoni nga portali zyrtar **e-albania** si posedues të kodit personal me kartë indentiteti.

Në rastin kur kjo nuk është e mundur, duhet të dorëzoni pranë komisionit një fotokopje të kartës tuaj të indentitetit, si dhe të plotësoni deklaratën personale në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

*Për arsye se numri i aplikuesve, është shumë i lartë, kjo e vështirëson shumë menaxhimin dhe më pas shqyrtimin korrekt të dokumentacionit në gjithë procesin.*

*Faleminderit për mirëkuptimin Tuaj!*